

## OSCAL 2023: Standing on the Shoulders of Hackers

Konferenca mbi teknologjite me kodburim të hapur në Shqipëri (OSCAL) po ndodh përsëri! Edicioni VIII do të mbahet edhe një herë në Shqipëri gjatë fundjavës së parë të shtatorit, më konkretisht 2 dhe 3 shtator në Tiranë.

### Rreth OSCAL

**Open Source Conference Albania** është konferenca vjetore ndërkombëtare në Shqipëri e organizuar për të promovuar lirinë e softuerit, softuerin me kod të hapur, kulturën e lirë dhe dijen e hapur, një lëvizje globale që filloi fillimisht **më shumë se 30 vjet më parë**. Si një organizim tërësisht vullnetar OSCAL është një konferencë që ka krijuar baza të forta dhe në komunitete open-source në Evropë.

### Standing on the Shoulders of Hackers

Çdo vit OSCAL zgjedh një tematikë të ndryshme që pasqyrohet në identitetin vizual të konferencës. Gjatë rrahjes së ideve, ekipi vlerësoi se të gjitha njohuritë që kemi pasur deri më tani janë mbledhur nga njerëzit që e kanë zhvilluar atë para nesh. A ka mënyrë më të mirë sesa ta pranojmë këtë dhe t'i bëjmë homazh secilit që na ka ndihmuar të bëhemi ata që jemi sot? Është e qartë se OSCAL po qëndron mbi supet e hakerëve të tjerë gjigantë dhe është koha që t'ju njohim, festojmë dhe jemi mirënjohës **për të gjithë ju!**

### Çfarë të prisni

Një program të larmishëm ligjërimesh, panele diskutimi, dhe punëtori të mbajtura nga anëtarë të komunitetit me open source të cilët i bashkohen OSCAL pa pagesë dhe **kontribues për një kohë të gjatë**. Prezantimet, punëtoritë, takimet me komunitetin, stendat e informacionit dhe ngjarjet sociale janë elementët e një recete standarde të OSCAL.

OSCAL inkurajon të gjithë entuziastët, zhvilluesit dhe organizatat me kod-burim të hapur që të bashkohen me ne në **#OSCAL23** si pjesëmarrës, vullnetar, ligjerues dhe/ose zhvillues punëtorie. Pavarësisht nëse jeni një profesionist me përvojë, student ose thjesht kurioz për teknologjitë me kodburimin të hapur, të drejtat dixhitale ose privatësinë në internet, OSCAL ofron një mjedis gjithëpërfshirës dhe mikpritës për të gjithë për të mësuar.

### Data të rëndësishme:

- Thirrje për ligjërues: deri në 15.08.2023
- Thirrje për vullnetarë: deri në 10.08.2023
- Thirrje për sponsor: deri në 15.08.2023
- Thirrje për partnerë mediatikë: deri në 15.08.2023
- Thirrje për info-booths: deri në 15.08.2023
- Lajmërimi i **venue**-së: 10.08.23

### Rreth Open Labs hackerspace

**Open Labs** është komuniteti me vendodhje në Tiranë që promovon teknologjinë me kod-burim të hapur, të përbashkëtën dixhitale dhe kulturën e privatësisë në internet që nga viti 2012. Është një organizatë joqeveritare jofitimprurëse në Tiranë që ofron një mjedis social dhe infrastrukturë për komunitete dhe iniciativa të tjera si **OpenStreetMap, Wikimedia Community User Group Albania, CryptoParty Tirana dhe Tirana Linux Group**. Anëtarët e komunitetit ndjekin një proces vendimmarrje horizontale që nga dita e parë.